



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Nr. _____ Prot

Data 26.05.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje karburant per nevojat e Bashkise Berat dhe drejtorive vartese”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

(FPP)_09100000-0 Karburante, **09134100-8** Karburant diesel

VLERA E FONDIT LIMIT: 25 447 999 (njezete e pesemilion e e katërqindë e dyzete e shtate mijë e nenteqind nentedhjetë e nente) leke pa Tvsh Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit,sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë sa vlera e përlogaritur e kontrates.

Kjo do të vërtetohet duke paraqitur vërtetim për xhiron lëshuar nga administrata tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë

Bazohet në nenin 43, pika 2, gërma b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar :

* në nenin 43 pika 1 të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;
* si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave;

2.2.2 Kopje të çertifikuara të bilanceve tre viteve të fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit [Nr.](#) 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ligjin [Nr.](#) 25/2018 datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të Ligjit [Nr.](#) 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Neni 57), Ligjit [Nr.](#) 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, si dhe VKM-së [Nr.](#) 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë leje tregëtimi ose autorizim për tregtim karburanti e lëshuar nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin nr.8450, dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin e naftës dhe nënprodukteve të tjera” me ndryshimet përkatëse .

Argumentimi:

Këto kriterë janë vendosur që operatorët ekonomik të jenë të pajisur sipas ligjit me lejet dhe autorizimet përkatëse për tregëtimin e këtij malli, në zbatim të Ligjit nr.8450 datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 970, datë 02.12.2015.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Kriteret e vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, përcaktojnë se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me licencat profesionale, të lëshuara nga autoritete kompetente shtetërore, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara në legjislacionin e sipërpërmendur. Pra konsiderohen si kritere të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet dhe i bazuar në LPP.

2. 3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me liçencë për Tregtim me pakice të karburanteve të lëshuar nga Pushteti Vendor Bashkia Berat .

Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 Stacion Tregtimi karburanti në territorin e Bashkisë Berat të vertetuar me Niptin përkatës dhe të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë

Këto stacione të jenë të pajisura me Vertetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitje me pakice, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmerisë datën e hapjes së ofertave .

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 5 germa a, 5. “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.4 Operatori Ekonomik duhet të disponojë minimalisht 1 Stacione Tregtimi karburanti në territorin e Bashkisë Berat të vertetuar me Niptin përkatës dhe të pasqyruara në Ekstraktin e shoqërisë.

Këto stacione të jenë të pajisura me Vertetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), dhe Police sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Shqiperi, per distributoret e shitje me pakice, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave

Argumentimi : Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK-së është bërë duke patur parasysh vendodhjen e objektit të bashkisë dhe dretorive vartës, numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe inteneraret ditore të grupeve të tererenit . që kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale, dhe se OE veprojnë brenda kornizës ligjore në fuqi lidhur me dokumentacionin përkatës për stacionet e shitjes me pakicë të karburantit.

Në zbatim të VKM Nr.561 date 29.07.2016 “Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme” sherbimi i furnizimit me karburant duhet te kryhet vetem nepermjet kartes elektronike,e cila mundeson identifikimin e mjetit dhe perdoruesin e saj.

2.5. Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë ISO 9001: 2015,ose ekuivalente (për të vertëtuar që operatori i plotëson kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë) lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

2.6.Operatori ekonomik ofertues duhet te ketë ISO 14001:2015, ose ekuivalente (për të vertëtuar që operatori plotëson kërkesat për sistemin e menaxhimit të mjedisit) lëshuar nga institucionet e akredituara për këtë qëllim, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme.

2.7.Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatën ISO 45001:2018 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit si dhe të jetë e vlefshme

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

- *Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Certifikaten ISO 14001: 2015 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, te jete e akredituar si dhe të jete e vlefshme.*

Argumentim:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vetë natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarde që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Çdo kompani ka detyrimin të mbrojtë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit.

ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë. ISO 45001 zëvendësoi standardin OHSAS 18001.

Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve. Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë. Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.

2.8 .Operatori ekonomik duhet të paraqesë Fletë Analiza të lëshuar nga ISHTI për produktin Diesel 10 PPM SSHEN:590 :2022 dhe Benzine SSHEN 228:2012 + A1:2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure si dhe bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe nenin 40 pika 6, gërm ”c” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.9.Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në çdo stacion furnizimi të tij, me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të AK sipas kërkesave të AK. Lista e automjeteve, Tipi dhe Targa e secilit automjet do të jenë pjesë e kontratës së fituesit, me AK.

Argumentimi :Referuar kërkeses se mesiperme duke qene se AK eshte ne sherbim operativ 24/7 lind nevoja e sherbimit 24 ore te furnizimit.

2.10.Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera të pakten 1 Autobote të transportit të lendeve të rrezikshme. Autobote duhet të jenë pajisur me Leje Qarkullimi, Kolaudimi (SGS), police sigurimi , certifikate për transportin e mallrave të rrezikshme.

2.11.Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër që të konvertojë të gjithë sasinë e litrave të ndodhura në kartën elektronike të personalizuar me targën e mjetit, në lëng me bot, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të AK

Argumentimi: Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu janë përcaktuar në funksion të vlerësimit dhe garantimit të cilësisë së mallit objekt prokurimi, aftësisë dhe zotërimit të aseteve të nevojshme fizike (mjete transporti/autobote) të operatorit ekonomik për të realizuar furnizimin e mallit (karburant) në përputhje me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara. Vetë natyra dhe rëndësia e veçantë e artikullit objekt prokurimi kërkon garancinë dhe vëmendjen e duhur si nga AK ashtu dhe nga operatorët ekonomik pjesëmarrës (për mjetet e renda qe nuk jane me goma, per mjetet e MZSH ne raste te vecanta operationale,).

2.12.Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant, detyrimisht me pistoletë publike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 dhe 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Kjo kërkesë është vendosur bazuar në objektin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

e prokurimit, kriter i nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës dhe që subjekti ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit në fuqi për trejetimin e karburabteve.

2.13. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë furnizimin me karburant me karte elektronike, e cila duhet të jenë pa skadencë dhe të jetë e përdorshme dhe gjatë vitit 2023 në përputhje me Vendimin e Keshillit të Ministrave **Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”**.

Argumentim:

Ky kriter plotësohet me dorëzimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje dhe në zbatim me VKM Nr. 561 date 29.07.2016 “Për standardizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet janë hartuar nga specialisti i fushës anëtar i njësisë së prokurimit, konform legjislacionit të prokurimit në fuqi dhe garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë.

NJESIA E PROKURIMIT

Specialist I fushës

Jurist

Specialiste (Ekon)

Denada Gjogu

Fjoralda Arapi

Ardisa Zhuka

MIRATOHET

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ERVIN DEMO